

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

KLAME

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K21518003F

NUIS/NIPT

Njesia Administrative 11, Koder Kamez, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I

Adresa

Tiranë

Albania

1000

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0686279075

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

zyratirana@gmail.com

E-mail

Administator Gëzim Shehi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2025/06/02

Data (viti/muaji/dita)

0686279075

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-48709-05-22-2025

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Bashkia Tirane

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

31074357

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Loti 2: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të institucioneve të Bashkisë Tiranë”

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2025/06/23

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2025/06/02

Numri i njoftimit

CN/44863/05222025

Kodi CPV

REF-48709-05-22-2025

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

Ligji Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per Prokurimet Publike”, i ndryshuar
VKM-se nr.285 date 09.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit ☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj. ☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. ☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër ☐

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Ne datën 23.05.2025, u publikua procedura e prokurimit me të dhënat e referuara më sipër. Nga shqyrtimi me kujdes i kërkesave për kualifikim, konstatohet se ato nuk janë hartuar në përputhje me urdherimet e legjislativës së prokurimeve publike. Duke qenë se jemi brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 110 të LPP, 23.05.2025-01.06.2025 por që për shkak se dita e fundit e ankesës përkon me ditë të diel jo pune, dita e fundit e ankesës shtyhet për në datën 02.06.2025 që është dita pasardhëse e punës po paraqesim pretendimet tona si në vijim:

Përshkruani në mënyrë koncize shkeletin e pretenduar, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

I. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar:

Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve që marrin përsipër për furnizim, për artikujt e kërkuar si më poshtë duhet të paraqesë dokumentacion të akredituar si “Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi” për produktet:

Karrige statike pa krahe mbështetës (Karrige), produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020+A1:2022 (SSH EN 1335-1:2021) Mobilje zyre - Karrige pune për zyrë - Pjesa 1: Dimensionet - Përcaktimi i dimensioneve, ose e njëjlefshme dhe e përditesuar, SSH EN 1335-2:2018 (Mobilje për zyrë - Karrige për zyrë - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë) ose e njëjlefshme dhe e përditesuar

- Tavoline pune e thjeshtë (tavoline pune/zyrë), produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 527-1:2011 Mobilje zyrash - Tavolinat e punës dhe tryezat - Pjesa 1: Përmasat, ose e njëjlefshme dhe e përditesuar SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 Mobilje për zyrë - Tavolina pune - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë, fortësisë dhe qëndrueshmërisë ose e njëjlefshme dhe e përditesuar - Sirtariere e levizeshme me rrota (Komode/Sirtariere), produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 15338:2007 + A1:2010 (15338:2024) Aksesorë metalik për mobilje – Rezistenca dhe qëndrueshmëria e mekanizmave zgjatues (shinat) dhe komponentëve të tyre, ose e njëjlefshme dhe e përditesuar.

Si dokument alternativ në vend të “Certifikate/Certifikate testimi/Raport testimi” të produkteve koresponduese të standardeve të mesiperme, operatori ekonomik mund të paraqesë Certifikata me reference standarde të mesiperme ose ekuivalente (Certifikata ekuivalente konsiderohen certifikate që nuk i referohet sistemit evropian EN të standardeve, por një sistemi tjetër standardesh por që trajton të njëjtat tregues dhe norma të testuara dhe konfirmuara të produktit si në sistemin EN)/të “Përditesuara” sipas standardeve SSH/EN mbi konformitetin e standardeve evropiane dhe të leshuara nga Organizma të Vlerësimit të Konformitetit të akredituara për leshimin e ketyre dokumentave në Republikën e Shqipërisë ose Organizma Nderkombëtare akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë, si dhe dokumenta të tjera alternative si “Certifikate/Deklarate Konformiteti”, “Deklarate CE” “Skeda Teknike”, “Pasaporta Teknologjike” me kusht që këta dokumenta alternative të jenë të shoqëruara me “Certifikatat e testimit/Raportet e Testimit” për

secilin produkt me reference standardised e kerkuara si me siper.

Çertifikatat e kerkuara duhet te jene te vlefshme ne periudhes se realizimit te procedures se prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose te njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatoret duhet te disponojne dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me raportin e pjesemarrjes ne furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

Kerkesa qe operatori ekonomik ofertues duhet ti paraqesi deshmi te testimeve zyrtare te kryera per mallrat si me siper referuar, eshte jo proporcionale dhe nuk i sherben qellimit te autoritetit kontraktor per tu garantuar se kontrata do te realizohet me sukses.

Referuar procesverbalit PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM, te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr.285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Keto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Bazuar në natyrën e objektit të prokurimit i cili ka punime dhe mobilim të ambjenteve është parë e arsyeshme kërkesa si më sipër për garantimin e cilësisë së punimeve dhe mallrave objekt prokurimi si dhe bazuar në Ligjin Nr.9870, datë 04.02.2008 Per standartizimin ku qëllimi kryesor i vendosjes së këtij kriteri është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, si dhe mjedisin, duke ndihmuar në zbatimin e legjislacionit, në funksion të kërkesave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurisë e shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, duke siguruar, në këtë mënyrë, rregulla të përbashkëta për të siguruar përdorimin me efektivitet të punës, të materialeve dhe të energjisë.

Ne nenin 40 pika 2, 3 dhe 6/ c te Vendimit te Keshillit te Ministrave me nr. 285, date 19.5.2021 Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik (i ndryshuar) nder te tjera percaktohet se:

”2. Per mallrat qe do te prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojne specifikimet teknike, te cilat duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, ne perputhje me nenin 36, te LPP-se, dhe qe i vlereson mallrat si te pranueshme per funksionet e kerkuara. 3. Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 77, te LPP-s. Kriteret duhet te jene ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet ti paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kriterave.

Ne mbeshetje te percaktimeve ligjore dhe nenligjore te sipercituara, autoriteti kontraktor ka argumentuar se ky kriter kualifikimi sherben per te pare mundesin e operatorëve ekonomik për përmbushjen e plotë të kontratës, për garantimin e cilësisë së punimeve dhe mallrave objekt prokurimi, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit. Shoqeria jone argumenton se kerkesat per realizimin e me sukses te kontrates permbushet me kriterin per sherbime-furnizime te ngjashme te realizuara 3 fitet e fundit, nderkohe kerkesat e cilesise vertetohen me kriterin e kualifikimit per ISO 9001:2015 ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise” (e vlefshme), kerkesa per mbrojtjen e mjedisit vertetohet me kriterin tjeter te kualifikimit ISO 14001:2015 ose ekuivalente ose Leje Mjedisore, Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit” (e vlefshme) si edhe kerkesa per ruajtjen e sigurine e shendetit vertetohet me kerkesen e kualifikimit per ISO 45001:2018/ ISO 45001:2023 (të përditësuar)ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme).

Gjithashtu në nenin 44 kërkesat e cilësisë të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në mënyrë elektronike në SPE nga autoriteti kontraktor, shoqëria jone konstaton, se në procesverbalin përkatës për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor nuk ka bërë asnjë argumentim lidhur me kriterin për kualifikimin, përkatesisht për kërkesën mbi raport testimi, cka është në kundërshtim me përcaktimet në pikën 2 të nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe cdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në cdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në cdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.”

Autoriteti kontraktor thjesht dhe vetëm sa ka referuar disa dispozita ligjore por në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht dhe në mënyrë analitike se përse kërkon TEST RAPORTIN. Në pikën 6, të Nenit 40 kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatoreve ekonomike të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rendesi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesë për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e cdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografite apo kataloget teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Referuar specifikimeve teknike të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE nuk rezulton në asnjë pikë të tyre të jete përshkruar nëse lenda e parë e përdorur për produktin final apo vetë ky i fundit duhet të jete rezistente ndaj zjarrit, goditjeve apo aksesoret e produktit final si vidat, dorezat etj duhet të përmbushin kushtet e rezistencës etj. Në mungesë të këtyre parashikimeve, autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë RAPORT TESTIMI se kështu ka lexuar diku në ligj fjalën test dhe

apriori i lind e drejta te kerkoje kete raport testimi. Dispozita ligjore eshte shume e qarte ne kete pike dhe nuk le vend per asnje interpretim apo keqinterpretim.

Nga ana tjeter, edhe sikur te pranojme se autoriteti kontraktor ka specifikuar kerkesat ne specifikimet teknike (nuk i ka specifikuar) serish eshte shume e rendesishme te veme theksin te fakti se referuar faqes Zyrtare te Drejtorise se Pergjitheshme te Standartizimit nuk rezulton qe ne Shqiperi te kete nje subjekt te akredituar per Testimin e Mobilerive apo aksesoreve te tyre.

Autoriteti ka anashkaluar faktin se perpara se te arrish te finalizosh nje testim zyrtar si fillim duhet te prodhosh produktin, qe te prodhosh produktin duhet te dish specifikimet teknike per te cilat ne rastin konkret te objektit te prokurimit merret informacion vetem pasi autoriteti ka publikuar proceduren dhe dst ne SPE. Pasi te disponohet ky informacion, vijohet me prodhimin e produktit i cili do kohen e vete pasi askush nuk duhet te hamendesoj se keto produkte mundet te prodhohen per nje dite por duan te pakten disa jave dhe muaj. Pasi te jete prodhuar produkti final i cili duhet te jete sipas specifikimeve teknike te kerkuara nga autoriteti, vijohet me hapin tjeter te nenshkrimet te nje marreveshje me Laboratorin e Certifikuar per Testimin e Mobilerive, qe me pas per te vijuar me pagesen perkatese e cila arrin vlere mbi 10.000 Euro dhe per te vijuar me tej me dergimin e mostrave me furgon jashte vendit, pasi sic permendem me siper nuk rezulton te kete laborator te akredituar ne Republiken e Shqiperise per testim mobilerish. Te besh nje testim jashte vendit pervec se duhet nje these me leke duhet minimalisht 3-4 muaj pasi keta laborator nuk i sherbejne vetem klienteve nga Shqiperia dhe duke i lene menjan shpenzimet per prodhimin, transportin dhe peripecit ne doganat e dy vendeve, serish nuk mjafton afati per ti paraqitur ato ne nje procedure prokurimi ku afati maksimal i mbylles se saj eshte 30 dite. Shoqeria jone gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret per kualifikim duhet te hartohen ne perputhje me LPP-ne dhe rregullat e prokurimit publik ne menyre te tille qe te nxisin pjesemarrjen dhe konkurrencen e operatoreve ekonomike, te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem, si dhe te sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, pjesemarrës ne keto procedura, per realizimin e sukses te kontrates me qellim zgjerimin e rrethit te pjesemarrjes se operatoreve ekonomike ne respekt te nenit 2 te LPP i cili parashikon shprehimisht se: qellim i ketij ligji eshte: a) te rrisë eficienten dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, pjesemarrës ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publikë. Ne nenin 79 standardet e sigurimit te cilesise dhe standardet e menaxhimit mjedisorë te ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per Prokurimet Publike”, (i ndryshuar) percaktohet: “1. Autoriteti ose enti kontraktor per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kerkoje ofertuesve dorezimin e certifikatave ose dokumenteve te ngjashme, te leshuara nga organe te pavarura, qe vertetojne pajtueshmerine e tyre me standardet e kerkuara te cilesise, vecanerisht sa i takon: a) garantimit te aksesit te personave me aftesi te kufizuara; b) efiaences se energjise; c) sistemeve te menaxhimit mjedisor. 3. Ne rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund te pajiset me nje certifikate te tille brenda nje kohe te arsyeshme per arsye qe nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund te pranoje dokumente te tjera, nepermjet te cilave mund te provohet garantimi i standardeve te kerkuara. 4. Ne Cdo rast, certifikatat e kerkuara duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimitë. Shoqeria jone gjykon se ne percaktimin/apo vendosjen e kriterëve specifike, qe ne thelb konsiderohen si kriterë fituese, per shkak te rendesise qe kane, ligjvenesit i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit qe ka ne perzgjedhjen e tyre. Ne kete

menyre, dispozitat e siperpermendura, urdherojne se percaktimi i ketyre kriterëve duhet te jete: (i) duke krijuar kushte dhe duke lene afat te arsyeshem per tu pajisur me keto certifikime (ii) propocional me objektin e prokurimit dhe (iii) duke respektuar parimin e mosdikriminit. Ne interpretimin teleologjik (qellimit) te dispozites se sipercituar, gjykojme se, qellimi i vendosur nga ligjvenesia, eshte dhenia e mundesise se autoritetit kontraktor, i cili eshte pergjegjes per prokurimin e fondeve publike te kryerjes se verifikimeve (egzaminim, inspektim, testim) nga autoriteti kontraktor te mallrave te dorezuara, ne rast se, keto te fundit jane ne perputhje me kerkesat e autoritetit kontraktor te pasqyruar ne specifikimet teknike te procedures se prokurimit objekt ankimi. Ligjvenesia ka kufizuar te drejten e autoritetit kontraktor mbi vendosjen e kriterit te mesiperme te kualifikimit ne respekt te parimit te proporcionalitetit, si nje parim gjithperfishires ne ligjin e prokurimit publik, duke e lidhur vendosjen e kriterit strictu sensu me rendesine qe ka per vleresimin nese kushtet teknike te sigurise te vendosura ne specifikimet teknike provohen se permbushen nepermjet testimit zyrtar ne kuptim te pikes 6 te nenit 40 te VKM-se nr. 285. Sa me siper, ne vleresimin e proporcionalitetit te kerkeses se autoritetit kontraktor mbi dorezimin e testeve per disa nga produktet duhet pare ne interpretim te zgjeruar me rendesine qe ka dorezimi i testeve per te vleresuar nese kushtet e sigurise te pasqyruara ne specifikimet teknike (nuk jane pasqyruar) provohen se permbushen nepermjet testimit. Ne vleresimin ligjor ne rast se kerkesa e mesiperme e autoritetit kontraktor ze peshen me te madhe, rendesine me te madhe, apo pa plotesimin e ketij kushti, autoriteti kontraktor nuk mund te realizoje qellimin e tij final ne vleresimin nese kushtet e sigurise te pasqyruara ne specifikimet teknike (nuk jane pasqyruar) provohen se permbushen nepermjet testimit, shoqeria jone gjykon se duhet interpretuar ne teresi neni 40 pika 6 i VKM 285. Ne rastin konkret, gjykojme se, synimi i autoritetit kontraktor lidhet drejtperdrejte me verifikimin e perputhshmerise se specifikimeve teknike te produkteve te ofruara nga operatorët ekonomike pjesemarres, me ato te kerkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderi. Per kete vleresim, shoqeria jone konstaton se autoriteti kontraktor ka kerkuar nje sere dokumentacioni, duke nisur nga:

? Kontratat e realizuara me sukses gjate 3 viteve te fundit;

? ISO 9001:2015 ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise” (e vlefshme), kerkesa per mbrojtjen e mjedisit vertetohet me kriterin tjeter te kualifikimit;

? ISO 14001:2015 ose ekuivalente ose Leje Mjedisore, Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit” (e vlefshme);

? ISO 45001:2018/ ISO 45001-2023 (të përditësuar)ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme);

? Garancia e mallrave do te jete jo me pak se 1 vit nga data e dorezimit te artikujve objekt prokurimi, gjate se ciles ofertuesi do te siguroje riparimin dhe mirembajtjen e tyre;

Me ane te dokumentacionit te mesiperme te kerkuar, ne gjykojme se autoriteti kontraktor mund te investigoje, krahasoje ne menyre te plote mbi perputhshmerine e produkteve te ofruara me ato te kerkuara. Kerkesa e autoritetit nuk i sherben qellimit per asye se edhe ata operator ekonomik qe mund ti kene raportet e testimi per tavolina apo dollape, serish nuk i kane ne menyre koncize sipas permasave dhe specifikave teknike per ato dollape apo tavolina qe i duhen kesaj procedure ose nese ata i kane atehere i bje qe keta kane patur informacion paraprak per specifikimet teknike dhe keto te fundit i'u jane dhene perpara se te publikohej procedura e prokurimit, cka do te bente shkelje te barazise se tenderave ne kuptim te Kodit Penal te Rep se Shqiperise.

Ne vijim te sa me siper, sa kohe eshte kerkuar qe shoqeria te jete e certifikuar sipas standarteve te referuara me siper, kjo verteton pajtueshmerine e materialeve te prodhuara me standartet e kerkuara dhe kerkesa edhe per testim raporti eshte nje dublim i kerkesave.

Sa me siper, duke u nisur edhe nga natyra e mallrave te kerkuar nga autoriteti kontraktor, shoqeria jone, gjykon se, kerkesa mbi dorezimin e testeve te sipercituara nuk eshte e rendesishme per vleresimin e ofertes teknike ne kuptim te nenit 40 pika 6 germa te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar. Akoma me tej, autoriteti kontraktor ka ne dispozicion edhe momentin procedural te kontrollit te dyte pas lidhjes se kontrates te

perputhshmerise se produkteve te furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar, me ato te kerkuar nga autoriteti kontraktor. Sqarojme se, ne baze te nenit 124 detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjate zbatimit te kontrates te LPP, autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. Sjellim ne vemendje te autoritetit kontraktor se, referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'iu siguruar nese cilesia e mallit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate.

Per te gjitha arsyet qe permendem me siper, shoqeria jone gjykon se kerkesa e mesiperme e autoritetit kontraktor nuk eshte proporcionale me objektin e procedures se prokurimit, natyren, permasat e kontrates si edhe me qellimin e kerkuar nga vete autoriteti kontraktor.

Madje, ne nje rast te ngjashem, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi qe merr vendime Administrativisht Perfundimtare, nepermjet Vendimit Nr. 357/2024, date 08.04.2024, pika III.5.4, ka vendosur qe kerkesa per Testim Raporti, te hiqet si nje kerkese e ekzagjeruar:

“KPP gjykon, se autoriteti kontraktor referuar procesverbalit te argumentimit te kriterëve, në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht pse është i domosdoshm për AK disponimi i raport - testimit. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argument dhe nuk ka justifikuar se në cilat standarde është mbështetur në hartimin kësaj kërkesë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriterë në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në cdo rast këto kriterë duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht, bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kriterëve për kualifikim joproporcionale dhe të pajustificuara, shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Ndaj KPP gjykon, se autoritetet kontraktore duhet të shmangin cdo kriter, apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim. Qëllimi i autoritetit kontraktor duhet të jetë nxitja e pjesëmarrjes së ofertuesve në procedurën e prokurimit, si dhe rritja e konkurrencës ndërmjet ofertuesve, për të siguruar ofertën më të sukseshme, që plotëson nevojat e autoritetit kontraktor me kosto më të ulët. Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qendrojnë.”

Akoma me tej, ne nje rast te ngjashem, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi qe merr vendime Administrativisht Perfundimtare, nepermjet Vendimit Nr. 1130/2024, date 29.08.2024, pika III.2.8, ka vendosur qe kerkesa per Testim Raporti, te hiqet si nje kerkese e ekzagjeruar:

“III.2.8 Nga shqyrtimi i dokumentave standarte të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit të kriterëve të ngarkuar në mënyrë elektronike në SPE nga autoriteti kontraktor, Komisioni konstaton, se në procesverbalin përkatës për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor nuk ka bërë asnjë argumentim lidhur me kriterin për kualifikimin, përkatesisht për kërkesën mbi paraqitjen e dëshmis të testeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, dhe certifikatat për produktet, çka është në kundërshtim me përcaktimet në pikën 2 të nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në cdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor referuar procesverbalit të argumentimit të kriterëve, në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht pse është i domosdoshm për

AK disponimi i dëshmis së testimeve zyrtare dhe certifikatat për produktet. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argument dhe nuk ka justifikuar se në cilat standarde është mbështetur në hartimin kësaj kërke. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto kritere duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht, bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kriterëve për kualifikim joproporcionale dhe të pajustificuara, shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Ndaj KPP gjykon, se autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim. Qëllimi i autoritetit kontraktor duhet të jetë nxitja e pjesëmarrjes së ofertuesve në procedurën e prokurimit, si dhe rritja e konkurrencës ndërmjet ofertuesve, për të siguruar ofertën më të sukseshme, që plotëson nevojat e autoritetit kontraktor me kosto më të ulët. Për autoritetin kontraktor, e rëndësishme është të sigurohet, që mallrat objekt - prokurimi do të jenë sipas standardeve të kërkuara, specifikimeve teknike të hartuara, siguri e cila në rastin konkret garantohet/realizohet nga paraqitja autorizim të prodhuesit ose distributori i autorizuar, të kërkuara në dokumentet e tenderit Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qendrojnë.”

Sa me sipër, autoriteti kontraktor duhet të beje modifikimet perkatese duke hequr kriterin e mesiperm per paraqitjen e raportin e testimit.

II. Në kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

2.3.4. “Operatori ekonomik sipas natyres se tij prodhues apo tregetues (operator prodhues konsiderohen ato operator qe nepermjet procesit te prodhimit transfromojne lendet e para dhe ndihmese ne produkte te gatshme apo montojne pjese te produktit te prodhuara nga subjekte te tjere duke i transformuar ne produkte te gatshem. Operator tregetues jane ato operator qe marrin pjese ne blerje-shitje te produkteve te gatshme pa marre pjese ne prodhim) duhet te kete minimalisht te punesuar punonjes sipas profesioneve me kode respektive apo te peraferta sipas listes se profesioneve miratuar me VKM nr. 514, date 20.9.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), te rishikuar”:

1 (nje) inxhinier druri (shoqerite prodhuese) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

1 (nje) arkitekt (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm

2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me (shoqerite prodhuese dhe tregetuese):

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit ne profesionin respektiv, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

1 (nje) shofer (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim.
- leje drejtimi, e vlefshme;

3 (tre) punonjës të thjeshtë (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) për veprimtari ndihmëse gjatë procesve të punës vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;

Shenim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime

nga autoriteti kontraktor.

Kerkesa, qe punonjesit e punesuar te jeni sipas profesioneve me kodet respektive apo te peraferta sipas listes se profesioneve te miratuar me VKM nr. 514, date 20.9.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), eshte nje kriter qe nuk ka lidhje me qellimin e hartimit te kriterëve te kualifikimit te cilat kane si synim krijimin e bindjes se autoritetit kontraktor se operatorët ekonomik me punonjesit dhe certifikimet apo kualifikimet e tyre perkatese qe kane te punesuar mund te realizojne me sukses kontraten ne rast se shpallen fitues. Per autoritetin kontraktor e rendesishme eshte disponimi i punonjesve te kualifikuar sipas specialiteteve por jo fakti se me cfare kodi jane te siguruar keta punonjes pasi sic edhe dihet publikisht nje punonjes mund te perdoret per disa specialitete me qellim plotesimin e nevojave te medha te punedhenesve per fuqi puntore dhe sigurimi i nje punemarresi si punonjes i thjeshte apo i siguruar me nje kod tjetër, i cili eshte i certifikuar apo diplomuar si marangoz nuk e zhben faktin se ai e permbush kerkesen e autoritetit kontraktor. Ne kete kuptim kerkojme heqjen e ketyre barrierave pasi specialitetin e nje punonjesi nuk e verteton kodi me te cilin figuron i siguruar por deshmia, certifikata/diploma e cila verteton specialitetin e kerkuar. Per kete arsye, kerkojme ndryshimin e kriterit duke hequr kufizimin ne lidhje me kodet e punesimit/sigurimit te punonjesve.

III. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete Sasia Gjendja

Mjet transporti me kapacitet mbajtes min 1.5 2 copë Pronësi ose me qera

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerese.

Shenim: Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr. 9 (Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: 1. Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”, të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në

dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikon shprehimisht se: Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë jenë të detyruar të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me specifikimet teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe

dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i ofertave nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt- ankimi, Procesverbaleve të hartimit të kriterëve, konstatojmë se autoriteti kontraktor në procesverbalin, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, në lidhje me kriterin e kualifikimit, ka Argumentuar:

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe të nenit 41, të pika 5/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Është kërkuar që kapaciteti mbajtës të jetë minimumi 1.5 ton, duke marrë parasysh llojin e mallrave që do të transportohen, peshën dhe përmasat që kanë, sidomos disa prej mobiljeve. Një mjet me kapacitet të tillë siguron që mallrat të transportohen të sigurt dhe pa dëmtime në vendndodhjet e kërkuara.

Përveç kësaj pike, AK ka kërkuar në pikën 2.3.11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me ane të se ciles merr persiper të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithë artikujve ne adresat e percaktuara ne planin e shperndarjes. Per ngjyrat e mobiljeve, duhet te kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

Referuar kërkesave sipërcituara, AK si përgjegjës për dokumentacionin e tenderit, duhet të ketë parasysh parimin e proporcionaliteti, bazuar kjo në rëndësinë e procedurës së prokurimit, objektin e kontratës, llojin e mallrave, si edhe sasinë, duke përcaktuar kriteret të thjeshtuara siç është procedura objekt - ankimi, për të lehtësuar punën e operatorëve ekonomikë dhe rritur pjesëmarrjen dhe konkurrencën. Akoma më tej, është përgjegjësi e operatorëve ekonomikë, që me nënshkrimin e kontratës, të realizojnë procedurën me mjetet e transportit në kohën e duhur sipas afateve të përcaktuara. Me nënshkrimin e kontratës operatori ekonomik është subjekti i parë i interesuar ta realizojë atë në kohë. Shoqëria jone thekson, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i mjeteve me kapacitet mbajtës të caktuar, por ky tregues i mjeteve duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të autoritetit kontraktor, i të gjitha elementeve të cituara më sipër, me qëllim përcaktimin e saktë të tonazhit, në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, si dhe në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve Gjithashtu, referuar DST, Procesverbalit mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt konstatojmë, se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për kapacitetin mbajtës së mjeteve të transportit. Autoriteti kontraktor ka deshtuar të argumentojë teknikisht se mjetet që mbajnë 500 apo 600 kg nuk arrijnë dot të kryejnë transportin e mallrave me sukses. Ne e dime se nuk ka mall që peshon me shume se 100-200 kg, cka do te thote se kemi te bejm me kriter diskriminues dhe pengues për operatorët ekonomikë.

Akoma me tej, në një rast të ngjashëm, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi që merr vendime Administrativisht Perfundimtare, nëpërmjet Vendimit Nr. 1130/2024, datë 29.08.2024, pika III.2.7, ka vendosur që kërkesa për një tonazh 1.5 ton për mjetet është e ekzagjeruar dhe duhet të modifikohet si një kërkesë e ekzagjeruar:

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt- ankimi, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, konstaton se ky i fundit, në procesverbalin, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, në lidhje me pikën 2.3.6 Argumentim: Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriterë janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “kërkon” nënkupton se këto kriteret janë kriterë detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë të paktën një automjet të përshtatshëm për transport mallrash (me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton), i cili është i nevojshëm për kryerjen e transportit të mallrave/ pajisjeve objekt prokurimi në instucionet arsimore sipas plan-shpërndarjes që do të përcaktohet nga autoriteti kontraktor, ku peshëmbajtja e tij është kërkuar në përpjestim me natyrën, specifikat, dhe përmasat e mallrave objekt prokurimi, pasi një mjet me tonazh më të vogël (ku rrjedhimisht dhe hapësira që ka) nuk mund të kryejë transportin e të gjithë mallit/ pajisjeve të kërkuara, kjo referuar dhe praktikave të mëparshme, ku furnizimi i tyre është kryer me kamiona me tonazh peshëmbajtje më të lartë se ajo e kërkuar, pasi në rast se furnizimi kryhet me mjete me tonazh më të vogël, kemi rritjen e kostove të rrugëve që do të kryejë, angazhimin e punonjësve të transportit dhe montimit, ku rrjedhimisht do të kemi vonesa dhe në kryerjen e furnizimit në kohëzgjatjen e përcaktuar të kontratës. Njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës me qëllim vërtetimin e disponimit të tyre, dhe dokumentacionin tekniko-ligjor të tyre të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik për qarkullimin e tyre”. Përveç kësaj pike, AK ka kërkuar në pikën 2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, pranë Autoritetit Kontraktor. Referuar kërkesave sipërcituara, AK si përgjegjës për dokumentacionin e tenderit, duhet të ketë parasysh parimin e proporcionaliteti, bazuar kjo në rëndësinë e procedurës së prokurimit, objektin e kontratës, llojin e mallrave, si edhe sasinë, duke përcaktuar kriterë të thjeshtuara siç është procedura objekt - ankimi, për të lehtësuar punën e operatorëve ekonomikë dhe rritur pjesëmarrjen dhe konkurrencën. Akoma më tej, Komisioni thekson, se është përgjegjësi e operatorëve ekonomikë, që me nënshkrimin e kontratës, të realizojnë procedurën me mjetet e transportit në kohën e duhur sipas afateve të përcaktuara. Me nënshkrimin e kontratës operatori ekonomik është subjekti i parë i interesuar ta realizojë atë në kohë. Komisioni thekson, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i mjeteve me kapacitet mbajtës të caktuar, por ky tregues i mjeteve duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të autoritetit kontraktor, i të gjitha elementeve të cituara më sipër, me qëllim përcaktimin e saktë të tij, në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, si dhe në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, aktit mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, si dhe aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për kapacitetin mbajtës së mjeteve të transportit. Operatori ekonomik në ankesën e tij, argumenton qartë pretendimet për modifikim të kriterit 2.3.6., si kriter diskriminues dhe pengues për operatorët ekonomikë. Për sa referuar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin 2.3.6, duke e modifikuar atë në lidhje me tonazhin e mjetit të transportit të mallrave. Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa referuar më sipër, Kërkojme ndryshimin e kriterit duke e ulur tonazhin e mejteve.

IV. Ne kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar:

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se zoteron në pronësi ose me qira ambiente prodhimi/magazinimi (nese është prodhues) jo më pak se 1000 m² dhe prodhimi/magazinimi (nese është tregëtues) jo më pak se 500 m²

a) Për ambientet në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e objektit sipas legjislacionit

b) Për ambientet me qira/huapërdorje, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton marrjen me qira dhe regjistrimin e objektit në pronësi të qiradhenesit.

Shenim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nese do të jete nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Referuar DST dhe kriterëve të përcaktura nga ana e autoritetit kontraktor vërejmë, se garancinë për zbatimin me sukses të kontratës, autoriteti e siguron nëpërmjet kriterëve të tjerë të kualifikimit sikurse është “përvoja e mëparshme e realizuar”. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që operatori ekonomik të vërtetojë, se gëzon kapacitetet e nevojshme për realizimin e furnizimit dhe nuk mund të përcaktojë kriterë në tejkalim të natyrës dhe objektit të prokurimit. Sqarojmë gjithashtu, se dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim, duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, në respekt të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik. Autoriteti kontraktor mundet nëpërmjet Ekstraktit të regjistrimit Tregtar të evidentojë se operatorët ekonomikë kanë ose jo një apo disa vende të ushtrimit të aktivitetit dhe nuk mundet të kërkojë kriterë ekstra për këtë pikë. Akoma më tej, operatorët ekonomikë janë të pajisur me leje mjedisi e cila jepet vetëm pasi janë kontrolluar ambientet ku ushtrohet aktiviteti i mobilitetit. Në këtë kuptim, kërkesa për ambient thjeshtë dhe vetëm sa shton burokracinë në ngarkimin e operatorëve ekonomikë me përparatjen e dokumentacioneve të cilat provohen në mënyrë të tjerë. Për këtë arsye kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

Akoma më tej, në një rast të ngjashëm, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi që merr vendime Administrativisht Përfundimtare, nëpërmjet Vendimit Nr. 861/2024, datë 11.07.2024, pikë III.4.6, ka vendosur që kërkesa për Ambient është e ekzagjeruar dhe duhet të hiqet:

III.4.6. Lidhur me pretendimet e ankimesit, se kërkesa për 1 ambient, për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt - prokurimi në pronësi/qira/përdorim, referuar specifikimeve teknike, sasisë dhe grafikut të lëvrimit të mallit, si dhe përmasave të kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është një kërkesë e ekzagjeruar, jo në përputhje me objektin dhe natyrën e objektit të prokurimit, e cila kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu, autoriteti kontraktor, ka të drejtë të kërkojë furnizime të pjesshme nga operatori ekonomik fitues, dhe është detyrë e këtij të fundit menaxhimi i kërkesave dhe përmbushja në kohë e tyre, për më tepër që plotësimi i këtij kriteri nuk është tregues mbi krijimin e besueshmërisë nga ana e autoritetit kontraktor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen me sukses të kontratës. Referuar DST dhe kriterëve të përcaktura nga ana e autoritetit kontraktor vërejmë, se garancinë për zbatimin me sukses të kontratës, autoriteti e siguron nëpërmjet kriterëve të tjerë të kualifikimit sikurse është “përvoja e mëparshme e realizuar”... Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që operatori ekonomik të vërtetojë, se gëzon kapacitetet

e nevojshme për realizimin e furnizimit dhe nuk mund të përcaktojë kritere në tejkalim të natyrës dhe objektit të prokurimit. Sqarojmë gjithashtu, se dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim, duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, në respekt të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik. Në këtë kuadër autoriteti kontraktor duhet të masa për heqjen e kriterit të përcaktuar më sipër. Sa më lart, pretendimi i ankimuesit qëndron.

Per keto arsye, kerkojme heqjen e kerkeses per ambient te referuar me siper si te pa bazuar ne ligj. Nga sa parashtruam dhe analizuam me siper, kerkojme:

? Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses;

? Pranimin teresisht te ankeses sipas parashtrimeve te referuara me siper duke modifikuar kriteret e kualifikimit.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

3. Rrethanat dhe faktet

Pershkruani rrethanat e faktit.

Ne daten 23.05.2025, u publikua procedura e prokurimit me te dhenat e referuara me siper. Nga shqyrtimi me kujdes i kerkesave per kualifikim, konstatojme se ato nuk jane hartuar ne perputhje me urdherimet e legjislacionit te prokurimeve publike. Duke qene se jemi brenda afatit 10 ditor te përcaktuar ne nenin 110 te LPP, 23.05.2025-01.06.2025 por qe per shkak se dita e fundit e ankeses perkon me dite te diel jo pune, dita e fundit e ankeses shtyhet per ne daten 02.06.2025 qe eshte dita pasardhese e punes po paraqesim pretendimet tona si ne vijim:

Pershkruani ne menyre koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qarte dhe sakte se perse pretendoni per paligjshmeri ne veprimet e autoritetit kontraktor.

I. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve qe marrin persiper per furnizim, per artikujt e kerkuar si me poshte duhet te paraqese dokumentacion te akredituar si “Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi” per produktet:

Karrige statike pa krahe mbeshtetes (Karrige), produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020+A1:2022 (SSH EN 1335-1:2021) Mobilje zyre - Karrige pune për zyra - Pjesa 1: Dimensionet - Përcaktimi i dimensioneve, ose e njevllefshme dhe e perditesuar, SSH EN 1335-2:2018 (Mobilje për zyra - Karrige për zyrë - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë) ose e njevllefshme

dhe e perditesuar

- Tavoline pune e thjeshte (tavoline pune/zyre), produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 527-1:2011 Mobilje zyresh - Tavolinat e punës dhe tryezat - Pjesa 1: Përmasat, ose e njevllefshme dhe e perditesuar SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 Mobilje për zyra - Tavolina pune - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë, fortësisë dhe qëndrueshmërisë ose e njevllefshme dhe e perditesuar - Sirtariere e levizeshme me rrota (Komedine/Sirtariere), produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 15338:2007 + A1:2010 (15338:2024) Aksesorë metalik për mobilje – Rezistenca dhe qëndrueshmëria e mekanizmave zgjatues (shinat) dhe komponentëve të tyre, ose e njevllefshme dhe e perditesuar.

Si dokument alternativ ne vend te “Certifikate/Certifikate testimi/Raport testimi” te produkteve koresponduese e standardeve te mesiperme, operatori ekonomik mund te paraqese Certifikata me reference standarde e mesiperme ose ekuivalente (Certifikata ekuivalente konsiderohet certifikate qe nuk i referohet sistemit europian EN te standardeve, por nje sistemi tjeter standardesh por qe trajton te njejtet tregues dhe norma te testuara dhe konfirmuara te produktit si ne sistemin EN)/te ”Perditesuara” sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe te leshuara nga Organizma te Vleresimit te Konformitetit te akredituara per leshimin e ketyre dokumentave ne Republiken e Shqiperise ose Organizma Nderkombetare akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, si dhe dokumenta te tjere alternative si ”Certifikate/Deklarate Konformiteti”, ”Deklarate CE” ”Skeda Teknike”, ”Pasaporta Teknologjike” me kusht qe keta dokumenta alternative te jene te shoqeruara me ”Certifikatat e testimit/Raportet e Testimit” per secilin produkt me reference standarde e kerkuara si me siper.

Çertifikatat e kerkuara duhet te jene te vlefshme ne periudhes se realizimit te procedures se prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose te njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatoret duhet te disponojne dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me raportin e pjesemarrjes ne furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

Kerkesa qe operatori ekonomik ofertues duhet ti paraqesi deshmi te testimeve zyrtare te kryera per mallrat si me siper referuar, eshte jo proporcionale dhe nuk i sherben qellimit te autoritetit kontraktor per tu garantuar se kontrata do te realizohet me sukses.

Referuar procesverbalit PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM, te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr.285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Keto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Bazuar në natyrën e objektit të prokurimit i cili ka punime dhe mobilim të ambjenteve është parë e arsyeshme kërkesa si më sipër për garantimin e cilësisë së punimeve dhe mallrave objekt prokurimi si dhe bazuar në Ligjin Nr.9870, datë 04.02.2008 Per standartizimin ku qëllimi kryesor i vendosjes së këtij kriteri është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, si dhe mjedisin, duke ndihmuar në zbatimin e legjislacionit, në funksion të kërkesave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurisë e shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, duke siguruar, në këtë mënyrë, rregulla të përbashkëta për të siguruar përdorimin me efektivitet të punës, të materialeve dhe të energjisë.

Ne nenin 40 pika 2, 3 dhe 6/ c te Vendimit te Keshillit te Ministrave me nr. 285, date 19.5.2021 Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik (i ndryshuar) nder te tjera percaktohet se:

”2. Per mallrat qe do te prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojne specifikimet teknike,

te cilat duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, ne perputhje me nenin 36, te LPP-se, dhe qe i vlereson mallrat si te pranueshme per funksionet e kerkuara. 3. Kërkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 77, te LPP-s. Kriteret duhet te jene ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktojte dokumentet konkrete qe duhet ti paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve.

Ne mbështetje te percaktimeve ligjore dhe nenligjore te sipercituara, autoriteti kontraktor ka argumentuar se ky kriter kualifikimi sherben per te pare mundesin e operatoreve ekonomik per permbushjen e plotë të kontratës, për garantimin e cilësisë së punimeve dhe mallrave objekt prokurimi, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit. Shoqeria jone argumenton se kërkesat per realizimin e me sukses te kontrates permbushet me kriterin per sherbime-furnizime te ngjashme te realizuara 3 fitet e fundit, nderkohe kërkesat e cilesise vertetohen me kriterin e kualifikimit per ISO 9001:2015 ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise” (e vlefshme), kërkesa per mbrojtjen e mjedisit vertetohet me kriterin tjeter te kualifikimit ISO 14001:2015 ose ekuivalente ose Leje Mjedisore, Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit” (e vlefshme) si edhe kërkesa per ruajtjen e sigurine e shendetit vertetohet me kërkesen e kualifikimit per ISO 45001:2018/ ISO 45001-2023 (të përditësuar)ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme).

Gjithashtu në nenin 44 kërkesat e cilësisë të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në mënyrë elektronike në SPE nga autoriteti kontraktor, shoqeria jone konstaton, se në procesverbalin përkatës për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor nuk ka bërë asnjë argumentim lidhur me kriterin për kualifikimin, përkatesisht për kërkesën mbi raport testimi , cka është në kundërshtim me përcaktimet në pikën 2 të nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: ”hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe cdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në cdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në cdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimitë.”

Autoriteti kontraktor thjesht dhe vetem sa ka referuar disa dispozita ligjore por ne asnje rast nuk ka argumentuar teknikisht dhe ne menyre analitike se perse kerkon TEST RAPORTIN. Ne piken 6, te Nenit 40 kërkesa te vecanta per kontratat e mallrave, te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 “Per

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatoreve ekonomike të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesë për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjale të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografite apo kataloget teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të leshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Referuar specifikimeve teknike të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE nuk rezultojnë asnjë pikë të tyre të jetë përshkruar nëse lenda e parë e përdorur për produktin final apo vetë ky i fundit duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit, goditjeve apo aksesoret e produktit final si vëndat, dorëzat etj duhet të përmbushin kushtet e rezistencës etj. Në mungesë të këtyre parashikimeve, autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë RAPORT TESTIMI se kështu ka lexuar diku në ligj fjalën test dhe apriori i lind e drejta të kërkojë këtë raport testimi. Dispozita ligjore është shumë e qartë në këtë pikë dhe nuk le vënd për asnjë interpretim apo keqinterpretim.

Nga ana tjetër, edhe sikur të pranojmë se autoriteti kontraktor ka specifikuar kërkesat në specifikimet teknike (nuk i ka specifikuar) serish është shumë e rëndësishme të vëmë theksin të faktit se referuar faqes Zyrtare të Drejtorisë së Përgjithëshme të Standartizimit nuk rezultojnë që në Shqipëri të ketë një subjekt të akredituar për Testimin e Mobilitetit apo aksesoreve të tyre. Autoriteti ka anashkaluar faktin se përpara se të arrijë të finalizojë një testim zyrtar si fillim duhet të prodhosh produktin, që të prodhosh produktin duhet të dish specifikimet teknike për të cilat në rastin konkret të objektit të prokurimit merret informacion vetëm pasi autoriteti ka publikuar procedurën dhe dësht në SPE. Pasi të disponohet ky informacion, vijohet me prodhimin e produktit i cili do kohën e vetë pasi askush nuk duhet të hamendësojë se këto produkte mund të prodhohen për një ditë por duan të pakten disa javë dhe muaj. Pasi të jetë prodhuar produkti final i cili duhet të jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti, vijohet me hapin tjetër të nënshkrimit të një marrëveshjeje me Laboratorin e Certifikuar për Testimin e Mobilitetit, që me pas për të vijuar me pagesën përkatëse e cila arrin vlera mbi 10.000 Euro dhe për të vijuar me tej me dërgimin e mostrave me furgon jashtë vëndit, pasi sic përmendëm me sipër nuk rezultojnë të ketë laborator të akredituar në Republikën e Shqipërisë për testim mobilitetit. Të bësh një testim jashtë vëndit përveç se duhet një thesë me leke duhet minimalisht 3-4 muaj pasi këta laborator nuk i shërbejnë vetëm klienteve nga Shqipëria dhe duke i lënë menjëherë shpenzimet për prodhimin, transportin dhe peripecit në doganat e dy vëndëve, serish nuk mjaftojnë afati për të paraqitur ato në një procedurë prokurimi ku afati maksimal i mbyllet se saj është 30 ditë. Shoqëria jonë gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatoreve ekonomike, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomike, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatoreve ekonomike në respekt të nenit 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondëve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatoreve ekonomike; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë

operatorët ekonomike, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publikë. Në nenin 79 standardet e sigurimit të cilësive dhe standardet e menaxhimit mjedisorë të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimet Publike”, (i ndryshuar) përcaktohet: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vertetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësive, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorezimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të leshuara nga organe të pavarura, që vertetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësive, vecanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në Cdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit. Shoqëria jone gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve specifikë, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësive që kanë, ligjvënisi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpermendura, urdherojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) duke krijuar kushte dhe duke lënë afat të arsyeshëm për tu pajisur me këto certifikime (ii) proporcional me objektin e prokurimit dhe (iii) duke respektuar parimin e mosdiskriminimit. Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, gjykojmë se, qëllimi i vendosur nga ligjvënisi, është dhënia e mundësive së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike të kryerjes së verifikimeve (egzaminim, inspektim, testim) nga autoriteti kontraktor të mallrave të dorezuara, në rast se, këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Ligjvënisi ka kufizuar të drejtën e autoritetit kontraktor mbi vendosjen e kriterit të mësipërm të kualifikimit në respekt të parimit të proporcionalitetit, si një parim gjithpërfshirës në ligjin e prokurimit publik, duke e lidhur vendosjen e kriterit strictu sensu me rëndësinë që ka për vlerësimin nëse kushtet teknike të sigurisë të vendosura në specifikimet teknike provohen se përmbushen nëpërmjet testimit zyrtar në kuptim të pikës 6 të nenit 40 të VKM-së nr. 285. Sa më sipër, në vlerësimin e proporcionalitetit të kërkesës së autoritetit kontraktor mbi dorezimin e testeve për disa nga produktet duhet parë në interpretim të zgjeruar me rëndësinë që ka dorezimi i testeve për të vlerësuar nëse kushtet e sigurisë të pasqyruara në specifikimet teknike (nuk janë pasqyruar) provohen se përmbushen nëpërmjet testimit. Në vlerësimin ligjor në rast se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor ze peshën më të madhe, rëndësinë më të madhe, apo pa plotësimin e këtij kushti, autoriteti kontraktor nuk mund të realizojë qëllimin e tij final në vlerësimin nëse kushtet e sigurisë të pasqyruara në specifikimet teknike (nuk janë pasqyruar) provohen se përmbushen nëpërmjet testimit, shoqëria jone gjykon se duhet interpretuar në teresi nën 40 pikë 6 të VKM 285. Në rastin konkret, gjykojmë se, synimi i autoritetit kontraktor lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomike pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Për këtë vlerësim, shoqëria jone konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar një sërë dokumentacioni, duke nisur nga:

- ? Kontratat e realizuara me sukses gjatë 3 viteve të fundit;
- ? ISO 9001:2015 ose ekuivalente, “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësive” (e vlefshme), kërkesa për mbrojtjen e mjedisit vertetohet me kriterin tjetër të kualifikimit;
- ? ISO 14001:2015 ose ekuivalente ose Leje Mjedisore, Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit” (e vlefshme);

? ISO 45001:2018/ ISO 45001-2023 (të përditësuar)ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme);

? Garancia e mallrave do te jete jo me pak se 1 vit nga data e dorezimit te artikujve objekt prokurimi, gjate se ciles ofertuesi do te siguroje riparimin dhe mirembajtjen e tyre;

Me ane te dokumentacionit te mesiperme te kerkuar, ne gjykojme se autoriteti kontraktor mund te investigoje, krahasoje ne menyre te plote mbi perputhshmerine e produkteve te ofruara me ato te kerkuara. Kerkesa e autoritetit nuk i sherben qellimit per asye se edhe ata operator ekonomik qe mund ti kene raportet e testimi per tavolina apo dollape, serish nuk i kane ne menyre koncize sipas permasave dhe specifikave teknike per ato dollape apo tavolina qe i duhen kesaj procedure ose nese ata i kane atehere i bje qe keta kane patur informacion paraprak per specifikimet teknike dhe keto te fundit i'u jane dhene perpara se te publikohej procedura e prokurimit, cka do te bente shkelje te barazise se tenderave ne kuptim te Kodit Penal te Rep se Shqiperise.

Ne vijim te sa me siper, sa kohe eshte kerkuar qe shoqeria te jete e certifikuar sipas standarteve te referuara me siper, kjo verteton pajtueshmerine e materialeve te prodhuara me standartet e kerkuara dhe kerkesa edhe per testim raporti eshte nje dublim i kerkeseve.

Sa me siper, duke u nisur edhe nga natyra e mallrave te kerkuar nga autoriteti kontraktor, shoqeria jone, gjykon se, kerkesa mbi dorezimin e testeve te sipercituara nuk eshte e rendesishme per vleresimin e ofertes teknike ne kuptim te nenit 40 pika 6 germa te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar. Akoma me tej, autoriteti kontraktor ka ne dispozicion edhe momentin procedural te kontrollit te dyte pas lidhjes se kontrates te perputhshmerise se produkteve te furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar, me ato te kerkuar nga autoriteti kontraktor. Sqarojme se, ne baze te nenit 124 detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjate zbatimit te kontrates te LPP, autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. Sjellim ne vemendje te autoritetit kontraktor se, referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t’u siguruar nese cilesia e mallit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate.

Per te gjitha arsyet qe permendem me siper, shoqeria jone gjykon se kerkesa e mesiperme e autoritetit kontraktor nuk eshte proporcionale me objektin e procedures se prokurimit, natyren, permasat e kontrates si edhe me qellimin e kerkuar nga vete autoriteti kontraktor.

Madje, ne nje rast te ngjashem, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi qe merr vendime Administrativisht Perfundimtare, nepermjet Vendimit Nr. 357/2024, date 08.04.2024, pika III.5.4, ka vendosur qe kerkesa per Testim Raporti, te hiqet si nje kerkese e ekzagjeruar:

“KPP gjykon, se autoriteti kontraktor referuar procesverbalit të argumentimit të kriterëve, në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht pse është i domosdoshm për AK disponimi i raport - testimit. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argument dhe nuk ka justifikuar se në cilat standarde është mbështetur në hartimin kësaj kërkesë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriterë në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në cdo rast këto kriterë duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumnin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht, bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kriterëve për kualifikim joproporcionale dhe të pajustificuara, shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Ndaj KPP gjykon, se autoritetet kontraktore duhet të shmangin cdo kriter, apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim. Qëllimi i autoritetit kontraktor duhet të jetë nxitja e pjesëmarrjes së ofertuesve në procedurën e prokurimit, si dhe rritja e konkurrencës ndërmjet ofertuesve, për të siguruar ofertën më të sukseshme, që plotëson nevojat e autoritetit kontraktor me kosto më të ulët. Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qendrojnë.”

Akoma me tej, ne nje rast te ngjashem, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi qe merr

vendime Administrativisht Perfundimtare, nepermjet Vendimit Nr. 1130/2024, date 29.08.2024, pika III.2.8, ka vendosur qe kerkesa per Testim Raporti, te hiqet si nje kerkese e ekzagjeruar:

“III.2.8 Nga shqyrtimi i dokumentave standarte të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit të kriterëve të ngarkuar në mënyrë elektronike në SPE nga autoriteti kontraktor, Komisioni konstaton, se në procesverbalin përkatës për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor nuk ka bërë asnjë argumentim lidhur me kriterin për kualifikimin, përketesisht për kërkesën mbi paraqitjen e dëshmis të testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, dhe certifikatat për produktet, çka është në kundërshtim me përcaktimet në pikën 2 të nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor referuar procesverbalit të argumentimit të kriterëve, në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht pse është i domosdoshm për AK disponimi i dëshmis së testimeve zyrtare dhe certifikatat për produktet. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argument dhe nuk ka justifikuar se në cilat standarde është mbështetur në hartimin kësaj kërke. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriterë në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto kriterë duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht, bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kriterëve për kualifikim joproportionale dhe të pajustificuara, shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Ndaj KPP gjykon, se autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim. Qëllimi i autoritetit kontraktor duhet të jetë nxitja e pjesëmarrjes së ofertuesve në procedurën e prokurimit, si dhe rritja e konkurrencës ndërmjet ofertuesve, për të siguruar ofertën më të sukseshme, që plotëson nevojat e autoritetit kontraktor me kosto më të ulët. Për autoritetin kontraktor, e rëndësishme është të sigurohet, që mallrat objekt - prokurimi do të jenë sipas standardeve të kërkuara, specifikimeve teknike të hartuara, siguri e cila në rastin konkret garantohet/realizohet nga paraqitja autorizim të prodhuesit ose distributori i autorizuar, të kërkuara në dokumentet e tenderit Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qendrojnë.”

Sa me siper, autoriteti kontraktor duhet te beje modifikimet perkatese duke hequr kriterin e mesiperm per paraqitjen e raportin e testimit.

II. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

2.3.4. “Operatori ekonomik sipas natyres se tij prodhues apo tregetues (operator prodhues konsiderohen ato operator qe nepermjet procesit te prodhimit transfromojne lendet e para dhe ndihmese ne produkte te gatshme apo montojne pjese te produktit te prodhuara nga subjekte te tjere duke i transformuar ne produkte te gatshem. Operator tregetues jane ato operator qe marrin pjese ne blerje-shitje te produkteve te gatshme pa marre pjese ne prodhim) duhet te kete minimalisht te punesuar punonjes sipas profesioneve me kode respektive apo te peraferta sipas listes se profesioneve miratuar me VKM nr. 514, date 20.9.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), te rishikuar”:

1 (nje) inxhinier druri (shoqerite prodhuese) vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës;

-diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

1 (nje) arkitekt (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) vërtetuar me:

kontratën individuale të punës;

-diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm

2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me (shoqerite prodhuese dhe tregetuese):

- kontratën individuale të punës;

- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit ne profesionin respektiv, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

1 (nje) shofer (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim.

- leje drejtimi, e vlefshme;

3 (tre) punonjës të thjeshtë (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) për veprimtari ndihmëse gjatë procesve të punës vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;

Shenim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca

9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kerkesa, qe punonjesit e punesuar te jeni sipas profesioneve me kodet respektive apo te peraferta sipas listes se profesioneve te miratuar me VKM nr. 514, date 20.9.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), eshte nje kriter qe nuk ka lidhje me qellimin e hartimit te kriterave te kualifikimit te cilat kane si synim krijimin e bindjes se autoritetit kontraktor se operatoret ekonomik me punonjesit dhe certifikimet apo kualifikimet e tyre perkatese qe kane te punesuar mund te realizojne me sukses kontraten ne rast se shpallen fitues. Per autoritetin kontraktor e rendesishme eshte disponimi i punonjesve te kualifikuar sipas specialiteteve por jo fakti se me cfare kodi jane te siguruar keta punonjes pasi sic edhe dihet publikisht nje punonjes mund te perdoret per disa specialitete me qellim plotesimin e nevojave te medha te punedhenesve per fuqi puntore dhe sigurimi i nje punemarresi si punonjes i thjeshte apo i siguruar me nje kod tjeter, i cili eshte i certifikuar apo diplomuar si marangoz nuk e zhben faktin se ai e permbush kerkesen e autoritetit kontraktor. Ne kete kuptim kerkojme heqjen e ketyre barrierave pasi specialitetin e nje punonjesi nuk e verteton kodi me te cilin figuron i siguruar por deshmia, certifikata/diploma e cila verteton specialitetin e kerkuar.

Per kete arsye, kerkojme ndryshimin e kriterit duke hequr kufizimin ne lidhje me kodet e punesimit/sigurimit te punonjesve.

III. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete Sasia Gjendja

Mjet transporti me kapacitet mbajtes min 1.5 2 copë Pronësi ose me qera

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerases.

Shenim: Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr. 9 (Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: 1. Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”, të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikon shprehimisht se: Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose

komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë jenë të detyruar të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me specifikimet teknike/ kriteret të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i ofertave nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt- ankimi, Procesverbaleve të hartimit të kriterëve, konstatojmë se autoriteti kontraktor në procesverbalin, "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim", në lidhje me kriterin e kualifikimit, ka Argumentuar:

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe të nenit 41, të pika 5/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Është kërkuar që kapaciteti mbajtës të jetë minimumi 1.5 ton, duke marrë parasysh llojin e mallrave që do të transportohen, peshën dhe përmasat që kanë, sidomos disa prej mobiljeve. Një mjet me kapacitet të tillë siguron që mallrat të transportohen të sigurt dhe pa dëmtime në vendndodhjet e kërkuara.

Përveç kësaj pike, AK ka kërkuar në pikën 2.3.11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me ane të se ciles merr persiper të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithë artikujve ne adresat e percaktuara ne planin e shperndarjes. Per ngjyrat e mobiljeve, duhet te kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

Referuar kërkesave sipërcituara, AK si përgjegjës për dokumentacionin e tenderit, duhet të ketë parasysh parimin e proporcionaliteti, bazuar kjo në rëndësinë e procedurës së prokurimit, objektin e kontratës, llojin e mallrave, si edhe sasinë, duke përcaktuar kriteret të thjeshtuara siç është procedura objekt - ankimi, për të lehtësuar punën e operatorëve ekonomikë dhe rritur pjesëmarrjen dhe konkurrencën. Akoma më tej, është përgjegjësi e operatorëve ekonomikë, që me nënshkrimin e kontratës, të realizojnë procedurën me mjetet e transportit në kohën e duhur sipas afateve të përcaktuara. Me nënshkrimin e kontratës operatori ekonomik është subjekti i parë i interesuar ta realizojë atë në kohë. Shoqëria jone thekson, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i mjeteve me kapacitet mbajtës të caktuar, por ky tregues i mjeteve duhet të

vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të autoritetit kontraktor, i të gjitha elementeve të cituara më sipër, me qëllim përcaktimin e saktë të tonazhit, në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, si dhe në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve Gjithashtu, referuar DST, Procesverbalit mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt konstatohet, se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për kapacitetin mbajtës së mjeteve të transportit. Autoriteti kontraktor ka deshtuar të argumentojë teknikisht se mjetet që mbajnë 500 apo 600 kg nuk arrijnë dot të kryejnë transportin e mallrave me sukses. Ne e dime se nuk ka mall që peshon me shume se 100-200 kg, cka do të thote se kemi të bëjmë me kriter diskriminues dhe pengues për operatorët ekonomikë.

Akoma me tej, në një rast të ngjashëm, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi që merr vendime Administrativisht Perfundimtare, nepermjet Vendimit Nr. 1130/2024, datë 29.08.2024, pika III.2.7, ka vendosur që kërkesa për një tonazh 1.5 ton për mjetet është e ekzagjeruar dhe duhet të modifikohet si një kërkesë e ekzagjeruar:

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt- ankimi, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, konstaton se ky i fundit, në procesverbalin, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, në lidhje me pikën 2.3.6 Argumentim: Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriterë janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “kërkon” nënkupton se këto kriterë janë kriterë detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë të paktën një automjet të përshtatshëm për transport mallrash (me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton), i cili është i nevojshëm për kryerjen e transportit të mallrave/ pajisjeve objekt prokurimi në institucionet arsimore sipas plan-shpërndarjes që do të përcaktohet nga autoriteti kontraktor, ku peshëmbajtja e tij është kërkuar në përpjestim me natyrën, specifikat, dhe përmasat e mallrave objekt prokurimi, pasi një mjet me tonazh më të vogël (ku rrjedhimisht dhe hapësira që ka) nuk mund të kryejë transportin e të gjithë mallit/ pajisjeve të kërkuara, kjo referuar dhe praktikave të mëparshme, ku furnizimi i tyre është kryer me kamiona me tonazh peshëmbajtje më të lartë se ajo e kërkuar, pasi në rast se furnizimi kryhet me mjete me tonazh më të vogël, kemi rritjen e kostove të rrugëve që do të kryejë, angazhimin e punonjësve të transportit dhe montimit, ku rrjedhimisht do të kemi vonesa dhe në kryerjen e furnizimit në kohëzgjatjen e përcaktuar të kontratës. Njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës me qëllim vërtetimin e disponimit të tyre, dhe dokumentacionin tekniko-ligjor të tyre të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik për qarkullimin e tyre”. Përveç kësaj pike, AK ka kërkuar në pikën 2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, pranë Autoritetit Kontraktor. Referuar kërkesave sipërcituara, AK si përgjegjës për dokumentacionin e tenderit, duhet të ketë parasysh parimin e proporcionaliteti, bazuar kjo në rëndësinë e procedurës së prokurimit, objektin e kontratës, llojin e mallrave, si edhe sasinë, duke përcaktuar kriterë të thjeshtuara siç është procedura objekt - ankimi, për të lehtësuar punën e operatorëve ekonomikë dhe rritur pjesëmarrjen dhe konkurrencën. Akoma më tej, Komisioni thekson, se është përgjegjësi e operatorëve ekonomikë, që me nënshkrimin e kontratës, të realizojnë procedurën me mjetet e transportit në kohën e duhur sipas afateve të përcaktuara. Me nënshkrimin e kontratës operatori ekonomik është subjekti i parë i interesuar ta realizojë atë në kohë. Komisioni thekson, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i

mjeteve me kapacitet mbajtës të caktuar, por ky tregues i mjeteve duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të autoritetit kontraktor, i të gjitha elementeve të cituara më sipër, me qëllim përcaktimin e saktë të tij, në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, si dhe në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndyshuar dhe nenit 40, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, aktit mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, si dhe aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për kapacitetin mbajtës së mjeteve të transportit. Operatori ekonomik në ankesën e tij, argumenton qartë pretendimet për modifikim të kriterit 2.3.6., si kriter diskriminues dhe pengues për operatorët ekonomikë. Për sa referuar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin 2.3.6, duke e modifikuar atë në lidhje me tonazhin e mjetit të transportit të mallrave. Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa referuar më sipër, Kërkojme ndryshimin e kriterit duke e ulur tonazhin e mjeteve.

IV. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

2.3.7. Operatori ekonomik duhet te deklaroje se zoteron ne pronesi ose me qira ambjente prodhimi/magazinimi (nese eshte prodhues) jo me pak se 1000 m² dhe prodhimi/magazinimi (nese eshte tregetes) jo me pak se 500 m²

a) Për ambjentet ne pronesi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e objektit sipas legjislacionit

b) Për ambjentet me qera/huaperdorje, duhet të paraqitet dokumenti qe verteton marrjen me qera dhe regjistrimin e objektit ne pronesi te qiradhenesit.

Shenim: Ky kriter do te konsiderohet i permbushur nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas Shtojces 9 te DST.

Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane autoritetit kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe nisjes se afateve te ankimit, ose nese do te jete nevoja per t'u kerkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Referuar DST dhe kriterëve të përcaktura nga ana e autoritetit kontraktor vërejmë, se garancinë për zbatimin me sukses të kontrates, autoriteti e siguron nëpërmjet kriterëve të tjera të kualifikimit sikurse është “përvoja e mëparshme e realizuar”. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që operatori ekonomik të vërtetojë, se gëzon kapacitetet e nevojshme për realizimin e furnizimit dhe nuk mund të përcaktojë kriterë në tejkalim të natyrës dhe objektit të prokurimit. Sqarojmë gjithashtu, se dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim, duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, në respekt të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik. Autoriteti kontraktor mundet nepermjet Ekstraktit te regjistrimit Tregtar te evidentoje se operatoret ekonomik kane ose jo nje apo disa vende te ushtrimit te aktivitetit dhe nuk mundet te kerkoje kriterë ekstra per kete pike. Akoma me tej, operatorët ekonomik janë të pajisura me leje mjedisi e cila jepet vetëm pasi janë kontrolluar ambjentet ku ushtrohet aktiviteti i mobilerise. Ne kete kuptim, kerkesa per ambient thjeshte dhe vetem sa shton burrokracine ne

ngarkimin e operatoreve ekonomik me pergatitjen e dokumentacioneve te cilat provohen ne menyra te tjera. Per kete arsye kerkojme heqjen e ketij kriteri.

Akoma me tej, ne nje rast te ngjashem, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi qe merr vendime Administrativisht Perfundimtare, nepermjet Vendimit Nr. 861/2024, date 11.07.2024, pika III.4.6, ka vendosur qe kerkesa per Ambient eshte e ekzagjeruar dhe duhet te hiqet:

III.4.6. Lidhur me pretendimet e ankimuesit, se kerkesa per 1 ambient, per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt - prokurimi ne pronesi/qira/perdorim, referuar specifikimeve teknike, sasisë dhe grafikut të lëvrimit të mallit, si dhe përmasave të kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është një kërkesë e ekzagjeruar, jo në përputhje me objektin dhe natyrën e objektit të prokurimit, e cila kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu, autoriteti kontraktor, ka të drejtë të kërkojë furnizime të pjesshme nga operatori ekonomik fitues, dhe është detyrë e këtij të fundit menaxhimi i kërkesave dhe përmbushja në kohë e tyre, për më tepër që plotësimi i këtij kriteri nuk është tregues mbi krijimin e besueshmerise nga ana e autoritetit kontraktor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen me sukses të kontratës. Referuar DST dhe kriterëve të përcaktura nga ana e autoritetit kontraktor vërejmë, se garancinë për zbatimin me sukses të kontrates, autoriteti e siguron nëpërmjet kriterëve të tjera të kualifikimit sikurse është “përvoja e mëparshme e realizuar”... Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që operatori ekonomik të vërtetojë, se gëzon kapacitetet e nevojshme për realizimin e furnizimit dhe nuk mund të përcaktojë kriterë në tejkalim të natyrës dhe objektit të prokurimit. Sqarojmë gjithashtu, se dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim, duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, në respekt të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik. Në këtë kuadër autoriteti kontraktor duhet të masa për heqjen e kriterit të përcaktuar më sipër. Sa më lart, pretendimi i ankimuesit qëndron.

Per keto arsye, kerkojme heqjen e kerkeses per ambient te referuar me siper si te pa bazuar ne ligj. Nga sa parashtruam dhe analizuam me siper, kerkojme:

? Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses;

? Pranimin teresisht te ankeses sipas parashtrimeve te referuara me siper duke modifikuar kriteret e kualifikimit.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☐

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

jo

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

jo

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. ☐

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

zyratirana@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Gëzim Shehi